

STATUTI

I

SHOQËRISË “*INFINIT CONSULTING*” *sh.p.k*

Në Tiranë, sot më datë 04/01/2018, me cilësinë e ortakëve themelues të Shoqërisë:

Z. Golem Duraku, shtetas Shqiptar, lindur në Morinë, Kukës më 06/04/1966 dhe banues në Tiranë në adresën Rr. Qemal Stafa, Tiranë, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr. 031447449,

Në cilësinë e “ortakut themelues” hartoj këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroj se me vullnet të lirë, të plotë e të sigurtë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, “*INFINIT CONSULTING*” *sh.p.k*

KREU I

Neni 1 Krijimi

Shoqëria “*INFINIT CONSULTING*” *sh.p.k.* është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar pranë QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “*INFINIT CONSULTING*” *sh.p.k.* është një shoqëri tregtare, e themeluar nga një ortak i vetëm i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut të vetëm përben kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortakët gezojnë kuotën e tyre në shoqëri në proporcim me kuotën që ka dhënë në kapital.

Neni 3 Selia

Shoqëria e ka selinë në bashkinë Tepelene, Lagjja Selam Musai, Rruga Dule Dalani, Pasuria nr.14/245, Zona Kadastrale 3574. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nëpërmjet vendimit vetëm nga Administratores si edhe të hapë zyrë perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Konsulencë për pasuritë e paluajtshme (studime fizibiliteti, vlerësime pasurish të paluajtshme, shtim kapitali, ndërmjetësim shitje blerje pasurive të paluajtshme, administrim i pasurive të paluajtshme, dhënie marrje me qira i pasurive të paluajtshme.

Handwritten signature

Konsulence Financiare (asistence profesionale ne pergatitjen e dokumentacionit per krijimin e shoqerive tregtare vendase ose te huaja si dhe per pergatitjen e planeve te tyre te biznesit, asistence ne procesin e krijimit, shkrirjes ose likujdimit te shoqerive tregtare nepermjet pergatitjes se raporteve te transparences per gjendjen financiare te ketyre shoqerive, vleresimit ne perputhje me standartet nderkombetare te asetëve dhe detyrimeve te tyre si dhe asistence juridike. Me kerkese te shoqerive investuse ose institucioneve financiare, te kreditit ose donatore bejme vleresime te projekteve per fizibilitetin e investimeve ne fusha te ndryshme te ekonomise, ne infrastrukture dhe administraten publike.

- Sherbime rreth Sektorit Bankar, Konsulence Bankare sipas nevojave te aktivitetit, Konsulence personale ne zgjidhjen e ceshtjeve Individuale. Shpjegime rreth produkteve qe ofrohen ne sektorin bankare dhe zgjedhjen e tyre sipas nevojave, Konsulence per investimin e fondeve

- Sherbime Kontabile (Mbajtje kontabiliteti sipas standarteve lokale dhe atyre nderkombetare (IAS); Pergatitja e pasqyrave financiare sipas standarteve lokale dhe atyre nderkombetare (IFRS); Informatizimi i kontabilitetit sipas parimeve kontabile te adaptuara. Pergatitja e buxhetit, Pergatitje e pasqyrave te cash floë-it, Analize e bilancit dhe pasqyrave financiar.

- Sherbimet e Taksave (sherbime dhe konsulencë ne ceshtjet e taksave per Shoqeri Aksionere, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe Organizata Jo-Fitimpruresë, Tatim mbi vleren e shtuar (TVSH), Tatim fitimi per bizneset, Tatim mbi te ardhurat personale, Sigurimet Shoqerore, Marrveshjet per eleminimin e taksave te dyfishta, Tatim ne Burim, Detyrimet Doganore)

- Sherbime per Pagat (sherbime per evidentimin e pagave te punojsve per kompani te cdo madhesie.

Mbledhja dhe rishikimi i evidencave qe lidhen me pagat e punonjësve Pergatitja e evidencave te pages bruto dhe pages neto mbeshtetur ne legjislacionin dhe standartet lokale Pergatitja e instruksioneve te pagesave te pages neto, sigurimeve shoqerore dhe tatimit mbi te ardhurat mbeshtetur ne legjislacionin dhe standartet lokale Pergatitja dhe paraqitja e pasqyrave te sigurimeve shoqerore dhe deklarimeve te ngjashme prane autoriteteve perkatese ne perputhje me kerkesat e legjislacionit vendas

- Shërbime në fushën e mjedisit. Hartimi i raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis(VNM). Përfshi raportet Paraprake dhe të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe auditimi mjedisor. Kryerja e ekspertizave të ndryshme në fushën e mjedisit, si dhe shërbime si ekspertë për të vlerësuar një raport të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Ekspertizat mjedisore të hartuara. Shërbime Konsulence teknike-profesionale dhe juridike në fushën e mjedisit.

- Hartimi i të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për aplikimet për VNM Paraprake dhe të Thelluar, si dhe për leje mjedisore të tipit A, B ose C.

- Aplikimi dhe ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme për një aplikim për miratim të VNM ose të një leje mjedisore, deri në miratimin dhe zbardhjen e dokumentit të lejes apo licencës. Në ndjekjen e procedurave për pajisje me Akt-Miratimi të VNM ose Lejeve Mjedisore përfshihen paraqitja e kërkesës për realizimin e procedurës së konsultimit me publikun, bashkërendimi dhe organizimi i konsultimit me publikun në përputhje me kërkesat ligjore, aplikimi pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe ndjekja e praktikës për plotësime informacioni të mundshme. Në perfundim printimi i licencës/lejes dhe dorëzimi i dosjes tek kërkuesi. Gjithashtu edhe hartimi i dokumentacionit dhe aplikimi për licenca profesionale në

Staraku

fushën e mjedisit të tilla si Licenca të aktivitetit të menaxhimit të mbetjeve dhe leje eksporti të mbetjeve.)

-Hartimi dhe përpilimi i raporteve të Auditimit Mjedisor.

-Hartimi dhe përpilimi i raporteve të Ekspertizës mjedisore për aktivitete të ndryshme në funksion të individëve, personave fizike, juridike institucione të ndryshme përfshirë institucionet e drejtësisë.

- Konsulencë për Çështjet e Mjedisit. Konsulencë juridike për çështjet e mjedisit, për procedurat e dokumentacionit për rastet e rivlerësimit dhe rinovimeve të lejeve mjedisore si dhe detyrimet që lindin si rrjedhojë e kuadrit ligjor dhe kushteve të lejeve mjedisore.

-RAPORTE PERIODIKE VETMONITORIME

Bazuar në kuadrin ligjor për mbrojtjen e mjedisit subjektet juridike kanë detyrim kryerjen e procedurës së vetmonitorimit për ndikimet që ata shkaktojnë në mjedis. Ky vetmonitorim kryhet periodikisht çdo 3-6 muaj.

-PROJEKTE PËR REHABILITIMIN MJEDISOR DHE PLANE TË MENAXHIMIT TË MJEDISIT

Hartimi i ekspertizave dhe projekteve të rehabilitimit të mjedisit me qëllime të minimizimit të ndikimit në mjedis të një aktiviteti i cili zhvillohet në një zonë pyjore, ose në mjedisin biologjik në teresi. (punimet e zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve të llojeve të ndryshme metalore dhe jometalorë, ndërtimi dhe venia në shfrytëzim të hidrocentraleve ndërtimi i rrugëve dhe i landfill-ëve të ndryshme, etj.

Punime Topogjeodezike, Punime Bazament Gjeodezike Për Rilevime Në Të Gjitha Shkallet, Planifikim Hapesinor Dhe Aplikime Gis

Ndermjetësimin në sigurime kryerjen e të gjitha veprimtarive, si prezantimi apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqëritë e sigurimit në emer dhe për llogaritë të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Këtu përfshihet edhe asistencë për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për demshperblim nga shoqëria e sigurimit, në emer dhe për llogaritë të konsumatorit

Sherbime Avokatie Ushtrimi i aktivitetit të avokatisë sipas rregullimeve të legjislativës në fuqi, mbrojtja e interesave dhe përfaqësimi gjyqësor i subjekteve kliente të zyrës së avokatisë, mbrojtjen ose përfaqësimin e klienteve jo gjyqësisht (sipasparashikimeve të nenit 12.3 të ligjit "Për profesionin e avokatit në RSH") dhe çdo aktivitet tjetër në përputhje me aktivitetin e një zyre avokatie.

Vlerësimi i makinerive, linjave teknologjike, depoziatave, enëve me presion, paisjeve, mjeteve motorrike, etj

Aktivitet në fushën e ndërtimit si: Aplikim leje ndërtimore, ndërtimin, rristrukturimin dhe modernizimin e objekteve civile, industriale, gërmime dhe ndërtime civile dhe ekonomike, prodhim dhe tregtim materiale inerte, ndërtime rrugësh, ndërtime urash dhe vepra arti, punime murature dhe beton arme, transport mallrash për vete dhe të tretet Projektimin, Ndërtim dhe montim të impianteve për prodhimin e energjisë nga burime të ndryshme, impiante elektrike për

Geduraku

centrale dhe prodhim te transformatoreve, montim i linjave te tensionit te larte dhe te ulet. Perdorimit te lendeve plasese e shperthyses.

Realizimin dhe drejtimin e strukturave te tilla si hotel, bar, restorante vetesherbime, ofiqina, pjese kembimi, transporte detare dhe tokesore. Prodhimin dhe perdorimin e shitjeve te materialeve inerte, trajtim

Import eksport dhe tregtim (shitblerje) me shumice e me pakice i te gjitha mallrave qe lejon legjislacioni I Republikes se Shqiperise, sidomos mallra industriale, ushqimore, fruta-perime, blegtorale, pije te ndryshme alkoolike e jo alkoolike e freskuese, veshmbathje, materiale ndertimi, pjese kembimi automjete, makinerive, mobiljeve, bime medicinale, lende drusore, plastike duralumini, materiale metalike, elektrike, telefonike, metale e minerale, lende e pare, shufra, profile si dhe prodhime te tjera metalike te llojeve e tipave te ndryshem artikuj shtepiake e shkollore, artikuj kozmetike e parfumerie, artikuj elektroshtepiake e elektrokulturore, pajisje dhe atrecatura per industrine e lehte, konfeksione e tekstile, automjete e mjete te tjera transporti, pjese kembimi automjetesh, pajisje e makineri te ndryshme, kompjutera e pajisje te tjera informatike. etj

Pllaka dhe pajisje hidraulike, lendeve te para per prodhimin e mobiljeve, makinerive per prodhimin dhe perpunimin e lendes drusore si dhe pjese kembimi per to, mobilieve dhe elementeve te tyre, lendeve te para e materialeve te ndertimit, duhan, cigare, konfeksione e tekstile , kepuce te çdo lloji, galanteri dhe artikuj lekure si dhe lende te pare per industrine e perpunimit te lekures, paisje kancelarie, artikujve te kozmetikes, dentare, optike, higjeno sanitare dhe paisje e vegla mjeksore te shërbimit human e veterinar. Plehra kimike e inorganike per bujqësinë si dhe artikuj e lende te para per industrine kimike e ate organike. ngjashme, brenda dhe jashte vendit.

Qiramarrjen, qiradhenien dhe leasing te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, mallrave dhe produkteve per realizimin e qellimit kryesor te shoqerise. Te kontraktoje me persona fizike dhe juridike vendas e te huaj, per gjetjen e tregjeve te reklamimit dhe te shitjes se produkteve te shoqerise. Te fitoje, direkt apo indirekt interesa ne shoqeri te tjera te cilat kane nje objekt te ngjashem me ate te Shoqerise , ne Shqiperi ose jashte saj. Shoqeria gjithashtu mund te realizoje cdo aktivitet te ligjshem tjeter te cilin ajo e cmon te nevojshem per realizimin e qellimeve te saj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj juridik dhe fiskal në (QKR) Regjistrin Tregtar, dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore te papercaktuar.

Kreu II
Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) lekë.

Kapitali i shoqërisë përbehet nga 1 kuotë me vlerë 100 % të kapitalit themeltar, e barabartë me 100.000 (Njëqind mijë) lek.

Sturua te u

Neni 7

Ortakët

Shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është **Z. Golem Duraku**, i cili është njëkohësisht zoterues i kuotës së vetme të kapitalit të shoqërise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërise përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërise.

Neni 8:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të ortakeve duke kontribuar në natyrë ose në para dhe shërbime. Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit deri në vlerën minimale.

Kërkohet vendim i kualifikuar edhe kur zmadhimi i kapitalit ka si qëllim t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

Me anë të një vendimit të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet.

Neni 9:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, duhet të përpilohet dhe firmoset kontratë me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, deri në çastin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

Neni 10

Organi Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakët i vetëm. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështje si:

Golem Duraku

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) të bleje, shese, kembeje pasuri të patundshme të shoqërisë;
- n) për shpërndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Neni 11 Administrimi

Administratori i shoqërisë është SEFRET ALLIAJ emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Neni 12 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatitisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në

G. G. G. G.

ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.

f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;

g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblee se Pergjithshme të shoqërisë vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e asamblesë së përgjithshme.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë asamblesë së përgjithshme për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore që ka.

Gduraku

Neni 16
Dividenti

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, Asamblesë së shoqërisë.

Neni 17

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqërisë.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Gjuraliku

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008..

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë: kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

Gduraku

bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes; vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23
Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare.
Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimit, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26
Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.
Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "INFINIT CONSULTING" sh.p.k, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij orgjinale.

ORTAKET E SHOQERISE

Golem Duraku

Golem Duraku

Gduraku